



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Departamenti i Mësimdhënies Lëndore
Me datë 12.05.2022

Vendimet për DISKUTIM PUBLIK					
#	Kandidati	Specializimi	Tema e punimit	Komisioni	
1	Argjira Zenuni-Buleshkaj	Mës.TIK	Efekti i përdorimit të veglave online në degëzimin e ideve tek nxënësit e nivelit të mesëm të ulët	Kryetar/e	Sylejman Berisha
				Mentor/e	Florent Bunjaku
				Anetar/e	Jehona Ferizi
2	Hadije Zucaku	Mës. Fizikë	Roli i eksperimenteve demonstruese në të nxënit e fizikës në shkollat e mesme të ulëta	Kryetar/e	Zeqir Shaqiri
				Mentor/e	Sadik Bekteshi
				Anetar/e	Ruzhdi Kuqi
3	Mentor Rrustemaj	Mës. Tek.TIK	Kompjuteri dhe interneti në favor të mësimdhënies - nxënies	Kryetar/e	Florent Bunjaku
				Mentor/e	Kyvetë Shatri
				Anetar/e	Rozafa Ferizi
4	Edona Krasniqi	Mës.GJLSH	Kompetenca gramatikore dhe komunikative - mësimi i Gjuhës shqipe në shkollë	Kryetar/e	Begzad Baliu
				Mentor/e	Xhavit Beqiri
				Anetar/e	Atdhe Hykolli
5	Xhemajlije Cana	Mës. Tek.TIK	Rëndësia e punës praktike në zhvillimin e shkathtësive profesionale të nxënësve në shkollat e mesme të larta	Kryetar/e	Arlinda Damoni
				Mentor/e	Sylejman Berisha
				Anetar/e	Florent Bunjaku

Kandidati/ja: 1. Argjira Zenuni-Buleshkaj

Tema: Efekti i përdorimit të veglave online në degëzimin e ideve tek nxënësit e nivelit të mesëm të ulët.

ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë përdorimi i veglave online si degëzim i mendimeve për arsimin e mesëm të ulët dhe efekti i përdorimit të tyre duke e vlerësuar situatën e të nxënësve dhe angazhimin e nxënësve të nivelit fillor në një mjedis klase, para dhe pas përdorimit të këtyre veglave online. Rasti i hulumtimit është bërë tek klasët e shtata, niveli fillor i mesëm i ulët, respektivisht në shkollën fillore ” Ismail Qemali “ në Prishtinë. Janë hulumtuar gjithsej 60 nxënës, dy klasë të shtata. Në këtë punim kam treguar se si duke përdorur këto vegla online që të rritet efekti tek nxënësit për degëzim të ideve. Me qëllim të mësimdhënies efektive vegla të tilla si: MindMeister janë mjaftë të përshtatshme për nxënësit dhe mësimdhënësit e arsimit fillor të mesëm të ulët. Vlerësimi i përdorimit të kësaj vegle është kryer në atë formë ku është bërë hulumtimi në dy klasë të shtata. Në njërin klasë është zhvilluar ora mësimore duke përdorur degëzimin e ideve në formë kllasteri në tabelë direkt nga nxënësit dhe në klasën tjetër eksperiment, ora është zhvilluar duke përdorur veglën MindMeister online, ku nxënësit janë kyç secili online dhe kanë dhënë mendimet e tyre duke bërë degëzimin e ideve gjatë zhvillimit të njësisë mësimore. Pas hulumtimit që është bërë, rezultatet kanë treguar edhe ndikimin nga përdorimi i veglës online MindMeister në krahasim me degëzimin e ideve në tabelë me anë të kllaster-it tek ajo klasë që nuk është përdorur kjo vegël. Ky rast studimi ka patur si qëllim një kontribut të veçantë, ku shihem edhe rezultatet e përdorimit të kësaj vegle gjatë një ore mësimore, dhe së dyti, realizimi i një ore mësimore pa përdorim të kësaj vegle. Gjatë hulumtimit është treguar se si ka ndikuar kjo vegël MindMeister në degëzimin e ideve tek nxënësit e klasëve të shtata. Gjatë këtij hulumtimi nxënësit kanë praktikuar platformën MindMeister online, dhe nga ky efekt i përdorimit edhe janë parë rezultatet. se si ka ndikuar kjo vegël, të cilat janë shfaqur me anë të grafikëve në secilën pyetje të pyetësorit.

Fjalët kyçe : Degëzim, Koncept, MindMeister, online, vegël.

Kandidati/ja: 2. Hadije Zuçaku

Tema: Roli i eksperimenteve demonstruese në të nxënit e fizikës në shkollat e mesme të ulëta

ABSTRAKTI

Mësimdhënia bashkëkohore në lëndët shkencore, e posaçërisht në lëndën e fizikës, kërkon zbatimin e metodave specifike të mësimdhënies dhe mësim nxënies me qëllim të arritjes së rezultateve sa më të mira në të nxënit e saj. Një prej metodave më efektive padyshim është edhe metoda e eksperimenteve demonstruese e cila në Kosovë nuk ka një zbatueshmëri të gjerë. Kështu një hulumtim për rolin eksperimenteve demonstruese në të nxënit e fizikës në shkollat e mesme të ulëta padyshim se do të jetë me interes të veçantë. Prandaj, në lidhje me këtë temë, pyetja hulumtuese është: sa ndikon zhvillimi i eksperimenteve demonstruese në përvetësimin e koncepteve dhe përmbajtjeve mësimore të fizikës tek nxënësit e shkollave të mesme të ulëta? Në bazë të pyetjes hulumtuese, u nxjerr një hipotezë kryesore: zhvillimi i eksperimenteve demonstruese e ngrit nivelin e përvetësimit të koncepteve dhe përmbajtjeve mësimore të fizikës tek nxënësit. Si metodë hulumtuese u përdor metoda statistikore. Hulumtimi u realizua me një mostër të rastësishme (N = 120) të nxënësve të klasës së 8-të në "SHMU 1", "SHMU 2" dhe SHMU "A.Z. Çajupi" në Vushtri. Pjesëmarrës në këtë hulumtim janë tri grupe testuese: grupi i nxënësve që marrin pjesë në eksperimente demonstruese moderne (shkurt. GEDM), grupi i nxënësve që marrin pjesë në eksperimente demonstruese tradicionale (shkurt. GEDT) dhe grupi i nxënësve që nuk marrin pjesë në eksperimente demonstruese (shkurt. GNED)

Për të provuar hipotezën e vendosur u përdor testi (pyetësori). Pyetjet e testit u formuluan, sipas udhëzimeve nga literatura bashkohore. si një kombinim i elementeve me zgjedhje të shumëfishtë dhe shpjegimit të dhënë nga nxënësit.

Rezultatet e fituara u paraqiten si frekuenca të ndryshoreve dikotomike numëruese të përgjigjeve dhe shpjegimeve të dhëna nga nxënësit. Vlerësimi i rezultateve të testit u krye ndaras për përgjigje dhe shpjegime. Rezultatet nga ky hulumtim tregojnë ndryshimet e rëndësishme statistikore në aspektin e të kuptuarit e koncepteve themelore të fizikës ndërmjet nxënësve të cilët kanë marrë pjesë në eksperimentet demonstruese me qasje moderne dhe tradicionale si dhe nxënësve të cilët nuk moren pjesë në eksperimente demonstruese.

Fjalët kyçe: demonstrim, diskutim, eksperiment, vrojtimit, fizikë, hipotezë, të nxënit.

Kandidati/ja: 3. Mentor Rrustemaj

Tema: **Kompjuteri dhe interneti në favor të mësimdhënies - nxënies**

ABSTRAKTI

Shekulli XXI konsiderohet si shekulli i informacionit, ku jeta nuk mund të imagjinohet pa kompjuter dhe pa internet. Thuhet se në shekullin XXI nuk jeni analfabet nëse nuk dini të shkruani apo të lexoni, por jeni analfabet nëse nuk dini të përdorni teknologjinë e Informacionit (kompjuteri dhe interneti). Kompjuteri, në fillim të përdorimit të tij, është parë si një mjet pasivë, dhe jo aq i rëndësishëm, kurse sot është pjesë përbërëse e procesit të mësimdhënies – nxënies. Si në të gjitha fushat e tjera, edhe në fushën e arsimit - përkatësisht në procesin e mësimdhënies – nxënies, kompjuteri dhe interneti, luajnë një rol të rëndësishëm. Rasti më i fundit, kur pandemia Covid – 19, e ka përfshirë pothuajse tërë botën, procesi /mësimor është realizuar në distancë (e – mësimi), u krijuan, përmes platformave të ndryshme, klasë virtuale dhe shumë çka tjetër, ku në këtë mes përpos teknologjive të tjera, kompjuteri së bashku me internetin zunë një vend të rëndësishëm.

Në këtë hulumtim është përdorur çasja induktive, është përdorur metoda e përzier (sasiore dhe cilësore) . Për mbledhjen e të dhënave janë përdorur instrumentet si më poshtë: intervistë përmes e-mail – it me mësimdhënësit dhe pyetësor elektronik (Google form) me nxënësit në dy shkolla, SH.F.M.U 8 dëshmorët - f.sh Kralan dhe SH.F.M.U Ukshin Miftari - fshati Skivjan, (janë përfshirë nxënësit nga klasa VII – IX dhe mësimdhënësit e ciklit të mesëm të ultë) në të dy shkollat, që të dyja në Komunën e Gjakovës. Gjithsejtë janë 120 nxënës dhe 10 mësimdhënës.

Nga rezultatet e nxjerrura nga ky punim kemi marrë përgjigje pozitive lidhur me përdorimin e kompjuterit dhe internetit në procesin e mësimdhënies – nxënies. Përgjigjet e marrura në hipotezën e parë të ngritur, mësimdhënësve dhe nxënësit kanë deklaruar se kompjuteri dhe interneti ndikojnë në rritjen e motivimit gjatë procesit të mësimdhënies – nxënies, po ashtu edhe në hipotezën e dytë të ngritur, mësimdhënësit dhe nxënësit janë deklaruar se kompjuteri dhe interneti ndikojnë në rritjen e interaktivitetit mësimdhënës – nxënës, gjatë procesit të e-mësimit. Pra, dy hipotezat e ngritura janë vërtetuar dhe testuar përmes programit SPSS.

Konkludojmë se kompjuteri dhe interneti ndikojnë në rritjen e motivimit gjatë procesit të mësimdhënies – nxënies, gjithashtu edhe në rritjen e interaktivitetit mësimdhënës - nxënës gjatë procesit të e-mësimit.

Fjalët kyçe: Kompjuteri, interneti, e-mësimi, mësimdhënia, nxënia.

Kandidati/ja: 4. Edona Krasniqi

Tema: **Kompetenca gramatikore dhe komunikative - mësimi i Gjuhës shqipe në shkollë**

ABSTRAKTI

Mësimi i Gjuhës shqipe në shkollë përbën një lidhje të rëndësishme të formimit gjuhësor dhe intelektual të fëmijës, duke e mundësuar jo vetëm zhvillimin e kompetencës gjuhësore/gramatikore, por edhe të shprehive të mira komunikative. Pra, mësimi i gjuhës në shkolla e ngrit edhe nivelin e kompetencës komunikative të nxënësit gjatë shkollimit të mesëm të ulët. Qëllimi i mësimi të Gjuhës shqipe është kompetenca komunikative, e cila tenton ta bëjë më të lehtë kuptimin dhe përdorimin e gjuhës si një urë komunikative e të gjitha veprimtarive të të nxënësit në klasë. Andaj, edhe qëllimi i këtij punimi mbështetet në këtë përkufizim, duke patur tri pikëqëllime: mësimi i gjuhës, zhvillimi i kompetencës gramatikore dhe asaj komunikative nëpër shkolla.

Në këtë hulumtim do të përdoret qasje metodike sipas qëllimit të kërkimit, konkretisht me anë të qasjes empirike, e cila e shqyrton dukurinë në mënyrë sa më objektive nëpërmjet vrojtimit, përvojave dhe instrumenteve, si dhe kombinimit të formave sasiore dhe cilësore, për të gjetur përgjigje më të sakta. Pra, metodë mikse të të dy elementeve. Teoritë e krahasimit dhe përdorimi i vëzhgimit do të na ndihmojnë për një pasqyrim më të drejtë në vrojtimin e mostrës.

Instrumentet do të përfshijnë qasjen e komunikimit, testet dhe esetë, që do të kenë funksionin e informatave bazë për pikënisjen e këtij hulumtimi. Instrumentet e tjera janë dhe librat shkollorë, gramatikat e shkollimit të mesëm të ulët (kl. VI- IX). Në fund të këtij punimi do të kemi rezultatin, i cili na tregon se a e kemi arritur pritshmërinë tonë, që nxënësit të jenë të zotë t'i njohin njësitë gramatikore, jo vetëm formalisht, por edhe t'i përdorin ato edhe gjatë komunikimit në përditshmëri.

Fjalët kyçe :

Kandidati/ja: 5. Xhemajlije Cana

Tema: Rëndësia e punës praktike në zhvillimin e shkathtësive profesionale të nxënësve në shkollat e mesme të larta

ABSTRAKTI

Ky hulumtim ka për qëllim të tregojë rëndësinë e punës praktike në zhvillimin e shkathtësive profesionale të nxënësve në shkollën e mesme të lartë. Kryerja e praktikës profesionale në vendin e punës është komponenta thelbësore e shkollës së mesme profesionale, në të cilën nxënësi i ka të përcaktuara objektivat e punës që ndërlidhen me mësimin teorik, ku njëkohësisht reflekton në mënyrë aktive në atë çka është duke mësuar. Aika mundësi t'i aplikojë njohuritë e fituara gjatë mësimin në një ambient pune, të zhvillojë shkathtësitë e tij, të kuptojë mjedisin e punës dhe të përfitojë nga përvoja dhe këshillat e mentorit dhe mbikëqyrësit. Gjatë kryerjes së praktikës në vendin e punës, nxënësi do të zgjerojë njohuritë e tij për shërbimet e caktuara dhe do të krijojë kontakte të reja, rrjete të cilat do t'i nevojiten për punësim në të ardhmen. Ai poashtu do të mësojë se si të menaxhojë kohën, si të sillë dhe të komunikojë me kolegët e punës dhe klientët.

Hulumtimi është realizuar në dy shkolla: në shkollën e mesme të lartë teknike "Nexhmedin Nixha" dhe në shkollën e mesme ekonomike "Kadri Kusari" në komunën e Gjakovës. Si mostër kemi katër klasë të 12-ta me gjithsej 110 nxënës. Të dhënat e analizuara janë grumbulluar duke përdorur metodën sasiore dhe cilësore. Pyetja kryesore e hulumtimit tonë është "Sa ndikon puna praktike gjatë procesit mësimor në zhvillimin e shkathtësive profesionale të nxënësve në shkollat e mesme të larta?", ndërsa si pyetje ndihmëse kemi "Sa ndikon gjinia në angazhimin në punën praktike gjatë procesit mësimor?". Duke përdorë pyetësorët me nxënës dhe intervistat me mësimdhënës dhe punëdhënës, kemi vërtetuar hipotezën kryesore e cila pohon se "Puna praktike e nxënësve në shkollat e mesme të larta ndikon pozitivisht në zhvillimin e shkathtësive profesionale.". Përveç kësaj kemi vërtetuar poashtu edhe hipotezën ndihmëse, që miraton se meshkujt janë më të angazhuar se femrat në punën praktike gjatë procesit mësimor.

Fjalët kyçe: Puna praktike, shkathtësitë profesionale, nxënësi, shkolla e mesme e lartë.